



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel ndihmësakademik me karakter administrativ, *Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Rektorat (DKMJ)*.

*Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë:* është përgjegjës për koordinimin dhe bashkërendimin e punës brenda drejtorisë si dhe strukturave të tjera përbërëse të UE-së, brenda kuadrit të zbatimit të Ligjit të Arsimit të Lartë; Koordinon dhe ndjek projektet kombëtare dhe ndërkombëtare ku UE merr pjesë dhe zbaton marrëveshjet dypalëshe; Organizon dhe është përgjegjëse për përfaqësimin në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, promovuese apo kërkimore shkencore ku UE është i përfshirë; Mban marrëdhëniet me universitetet brenda dhe jashtë vendit, duke koordinuar aktivitetet në kuadrin e Rrjeteve Universitare Evropiane e Ballkanike, monitorimin e zbatimit të projekteve në të cilat merr pjesë institucioni; Raporton tek titullari, harton raporte, kryen analiza periodike dhe propozon zgjidhje në rastet kur është e nevojshme në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kandidatët duhet të plotësojnë kritere të përgjithshme e të veçanta për këtë pozicion pune.

### **Kriteret e përgjithshme:**

- të ketë mbaruar studimet universitare (Master i Shkencave) në fushën e shkencave politike/humane/sociale/komunikimit. Diplomat e marra jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- të ketë përvojë pune në pozicion të njëjtë apo të ngjashëm.
- të zotërojë me dëshmi një nga gjuhët e huaja të Bashkimit Europian.
- të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- të jetë i aftë për punë.

### **Kriteret e veçanta:**

- të ketë mbi 3(tri) vite pune në hartimin, manaxhimin, zbatimin, monitorimin e projekteve të ndryshme.
- të ketë aftësi shumë të mira të shkrimit të dokumentacionit në gjuhën shqipe dhe të huaj.
- të ketë aftësi shumë të mira koordinimi, organizimi dhe prezantimi takimesh.
- të ketë kryer trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse
- të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

Kandidatët duhet të dorëzojnë **në rrugë postare** nga data **10.07.2023** deri më **19.07.2023** dokumentacionin e mëposhtëm:

- Letër motivimi për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njësuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, rekomandime/referenca për aftësi të ndryshme, të njësuar me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njësuar me origjinalin;
- Raport i aftësisë për punë, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Të interesuarit duhet të dërgojnë **në rrugë postare brenda afatit** dokumentacionin e tyre në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyma”,  
Aplikim për pozicionin e punës së Drejtor**

Komisioni ad-hoc do të vlerësojë dosjet e kandidatëve paraprakisht dhe më pas ata do të nënshtohen intervistës me gojë. Konkursi do të zhvillohet në Rektoratin e UE-së, Brenda periudhës (21.07.2023 - 31.07.2023). Kandidatët konkuroes do të njoftohen elektronikisht brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike për rezultatet paraprake të konkurrimit dhe shpallja/njoftimi i fituesit.